

J



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË PESTË TË RREGULLT TË KUVENDIT KOMUNAL TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Mbledhja është mbajtur më dt: 24.05.2016 (E martë) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira, nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu, këshilltaret e Kuvendit, Sami Demelezi, Zekrija Zuka, Nexhat Aliu, Xhilsime Qamili, Ali Bajrami, Adnan Imeri, Arbresha Ibrahim, Vjollca Kadolli - Halili, Nuredin Lutfiu, Ajtene Frangu, Bekim Azizi, Samet Idrizi, Taib Alidema, Hyse Rama, Visar Demiri, Bislim Bislímaj, Sejdi Emini, Baki Nebiu, Daut Xhemajli, Vjollca Sylejmani, Ekrem Abaz, Vehbi Rama, Mirlinda Sadiku, Majlinda Ostrogllava, Selvije Rexhepi, Besjana Rexhepi.

Në mbledhje morën pjesë edhe, drejtorët e drejtorive, zyrtarja e zyrës Ligjore, zyrtari për integritet evropian, zyrtarja për barazi gjinore, përfaqësuesi i OSBE-së, mjetet e shkruara dhe elektronike.

Kryesuesi shfrytëzoi rastin të përshëndes edhe punëtorin e ri, zyrtarin profesional të Kuvendit Komunal, z.Fatlum Demiri, i cili është prezent, i cili nga tash e tutje do të përcjell seancat e do të mbaj procesverbalin.

Pasi u konstatua se prezent janë 27 anëtarë të KK-së, andaj kemi kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Përshëndetje për Nënkryetarin e Komunës, të gjithë ju Anëtarë të KK-së si dhe ju të pranishëm dhe mirë se keni ardhur në mbledhjen e -V- të rregullt të KK-së. Kryesuesi i njoftoj të pranishmit se ka marr konfirmim nga Ministria e Pushtetit Lokal që të gjitha aktet e nxierë nga seanca e kaluar janë në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje lokale, e ku i falënderoj asamblistët për kontributin e dhënë në këtë aspekt. Me që jem te urimet do të doja që ti urojmë Besianës magistraturën, e cila ka përfunduar këto dite dhe i dëshiroj suksese edhe në të ardhmen e ku besojmë që shumë shpejtë do ta kemi një personalitet me titullin e doktorit, natyrisht dhe para që të kalojmë në miratimin e rendit të ditës e kam një kërkesë nga përfaqësuesi i OSBE-se, Meqenëse në seancën e kaluar e kemi formuar Komitetin për Barazi Gjinore, këta kanë caktuar një seancë me 1 Qershor në ora 10:30. Ju e dini që kush janë anëtarë

te këtij komiteti, Ajtene Frangu, Hyse Rama, Majlinda Ostergllava, Vebi Rama, Tefik Salihu, qe të gjithë anëtarët e komitetit do të thotë qe me 1 Qershor ne ora 10:30, është takimi i radhës i këtij komiteti. Para qe te kalojmë ne rendit e ditës kisha dashur nga ju meçe qe u raportua ne seancës e fundit qe pyetjet dhe përgjigjeje te jenë të limituara dhe ta kenë një kohëzgjatje diku prej 30 minuta, e nëse ka nevojë për diskutim te mëtutjeshëm ne si Kuvend kem te drejtën te caktojmë edhe pikë të venat te rendit te ditës.

Kryesuesi pyeti se a ka kush të thotë diçka para se të paraqesim rendin e ditës dhe ua kaloj fjalën anëtarëve të Kuvendit.

znj.Mirlinda Sadiku: Përshëndetje për të gjithë! Do të mundohem te jem sa me racionale, sepse kam një varg pyetje. Zyra e Financave, një pyetje: Pse është vonuar tenderi për asfaltimin e rrugës se Lubishtes? Sipas planit te prokurimit ka qene data: 01.03.2016, ndërsa me faqen zyrtare është publiku me datën: 04.05.2016. Pyetjen e dytë për Drejtorinë e Bujqësisë, se ka ndodhë kjo e tregon ne fotot: Pse u masakruan 200 pisha ne fshatin Terpezë, kush është përgjegjës për këtë, si ndodh qe një operator ekonomik vjen e masakron pyllin dhe e bënë këtë gjendje, kjo është për tu diskutua kam pas dëshirë qe te shkoj ta vizitoj këtë vend, mirëpo nuk kam mund prej rrugës, shikoni se ne çfarë gjendje është rruga, një nxënëse mi ka dërguar fotot i cili ka kërkua te jetë anonim, prandaj është mjaft shqetësuese. Pyetja tjetër është, me datën 03.05.2016 është publiku tenderi për restaurimin e shkollës se parë shqipe ne Stubëll të Vitisë, vlera 28 mije euro: Drejtor, nga ka ardhur ky investim ku ky nuk gjendet ne planin e prokurimit? Faleminderit!

Kryesuesi z.Naim Pira: Faleminderit znj.Mirlinda, ti edhe ne seancën e kaluar ki parashtruar një pyetje, harrova, pak me herët te informoj, sepse përgjigja e keni marr si duket me shkrim apo besoj qe edhe pyetje e parashtruar sot do te merrni përgjigje.

z.Sami Demelezi: Përshëndetje për te gjithë të pranishmit, unë nuk dola pyetje me bë, por dola vetëm mi tregu Mirlindës qe ka edhe alternativa tjera për me shkua ne fshatin Tërpezë, është nga Novosella për mi ra këput një rruge andej e me dal prej Navoselles ne Pozharan e me dal në Terpezë, pra mu nis nga lagja “Pirajt”, ajo rruga qe është e asfaltuar, prandaj ki pas mundësi me shkua po mos i dramatizo gjërat kaq shumë.

z.Bekim Azizi: Faleminderit për fjalën, përshëndetje për kryesuesin, nënkryetarin, anëtarët e Kuvendit dhe për të pranishmit e tjerë. Unë isha lidhur në dy çështje tjera ne gjimnaz, dy mësime kanë dal ne pension qe dy muaj e këndeje, tash ka dal edhe i treti, po nuk po e lidhë me këtë. Kush i ka mbajtur këto orë, kush u angazhua, konkurse nuk ka pas, orët janë majtë, probleme ka pas, dikush i mban orët dikush nuk i mban orët, d.m.th aq shumë e kanë pështjell aty, unë e kisha bërë një kërkesë, një pyetje që me na tregu drejtori se çka është puna me këto orë. Tjetra, çka e kisha lidhur çështjen e pishave, e diskutoj Mirlinda, se pata me diskutua. Kohen e fundit qenet endacak janë tu na sill ne qytet shumë: A keni marre diçka d,m,th ne këtë drejtim për mi largu këta qenë endacak nga qyteti?, se është rrezik. Edhe ne fund kisha kërkuar një listë te rrugëve rurale për asfaltim, cilat rrugë janë sivjet, besoj qe kjo duhet mu përgatit. Ju faleminderit!

znj.Majlinda Ostroglava: Faleminderit Kryesues, përshëndetje për te gjithë Kolegë të nderuar, qytetar të Vitisë. Të nderuar koleg, unë sot e beje një njoftim, ku edhe arsyet e mija kanë qen publike, ku tash e tutje nuk do ta përfaqësoj Lëvizjen Vetëvendosje, do te jem plotësisht e pavarur, gjithherë ne mbrojtje te interesave te qytetarëve të Vitisë dhe do ti përmbahemi parimeve të cilat i kamë përcjell gjithherë. Ju faleminderit!

z.Nuredit Lutfiu: Faleminderit kryesues, përshëndetje për te gjithë! Kam një kërkesë për kryetarin e Komunës, z.Sokol Halitin, drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, z.Qahil Sinani. Në mbledhjen e mbajtur me datën 24.05.2016, Këshilli i Prindërve të Çerdhes së vetme publike në komunën tonë, gjegjësisht në qytetin e Vitisë "Gëzim Ynë", kërkon nga Kryetari i Komunës dhe Drejtori i Arsimit të rinovohet çerdhja, për arsye se në kushtet në të cilët gjendet çerdhja momentalisht nuk i plotëson standardet për një zhvillim dhe edukim të suksesshëm të fëmijëve, të cilët janë pjesë e saj.e respekt këshilli i prindërve të çerdhes së qytetit të Viti-se "Gëzim Ynë".

z.Adnan Ymeri: Përshëndetje për te gjithë te pranishmit, përshëndetje për Kryesuesin, Nënkryetarin! Si çdo fshatë tjetër edhe fshati Sllatinë e Epërme i është bashkuar aksionit ose iniciativës "Ta pastrojmë Kosovën", përjashtimisht që është pastrua i gjithë fshati kemi mënjanur edhe një deponi të madhe të mbeturinave në vendin e quajtur Bllak dhe për këtë iniciativë i kisha falënderua këshillin e fshatit dhe banoret të cilët kanë marrë pjesë, gjithashtu për përkrahjen e kisha falënderua edhe Komune e Vitisë. Ju faleminderit!

z.Bislim Bislimi: Para disa ditësh është vërejt se i kanë bërë ato shiritat në rrugë, unë sot kalova në disa shirita i pash që ishin repë me një herë: A ka marrë dikush masa për atë punë që e ka bërë dikush, sa është paguar ajo, sa kanë marr shpërblime ajo kompani edhe a do ta përsërisin punën apo çka do të bëjnë.

Kryesuesi z.Naim Pira: A ka ndonjë pyetje, nëse nuk ka unë vërtet ju falënderoj sot parafolësit për kontributin e dhënë, që ishte shumë konciz në shfrytëzimin e kohës, natyrisht u parashtrua një numër i pyetjeve, disa ishin rreth Drejtorisë së Arsimit, nuk e kem sot këtu prezent drejtorin e Arsimit, i cili është me një takim, por do të ja përcjellim pyetjet e juaja e ku besoj që ato të cilat i përkasin ati do të na jep përgjigje dhe për te tjerat e kemi nënkryetarin këtu, besoj që ju jep përgjigje, urdhëro nënkryetar.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Fillimisht me lejoni ta përshëndes kryesuesin juve këshilltar të Kuvendin Komunal të Vitisë, drejtorët e drejtorive, shoqërinë civile, media të shkruara dhe elektronike, është kënaqësi të prezantosh në Kuvendin e Vitisë dhe interesimin e këshilltarëve të cilët shtrojnë pyetje, të cilët i prekin interesat edhe të qytetarëve të Komunës së Vitisë ndoshta edhe sjellin edhe dobi, por në disa raste mund të sjellin edhe dëme të cilët në jemi si qeveri komunale të cilët duhet të luten për mënjanimin e tyre. Megjithatë edhe pyetjet duhen të shtrohen në formën ashtu qyshe ka ndodhe e jo me tendencë, tendencat nuk na qojnë askund përpara ato janë të këqija dhe nuk i sjellin as qytetarëve as këshilltarëve as askujt të mira, megjithatë unë po bëjë përpjekje, besoj krejt i kam shënua fatmirësisht që sot keni fol pak me ngadalë e ku kam arrit mi zanë të gjitha çështjet. Te koka shume problematik nëse është shty dy tri dite çështja e procedurave të tenderimit të asfaltimit të Lubishtës. Unë konsideroj që nuk ja vlen që të bisedohet ajo çështje për shkak se ju e dini që ka kompani e cila e bënë projektin dhe është kompani e jashtme, që Komuna e Vitisë dhe të gjitha komunat janë të obliguara ta shpallin fitues kompania e cila ka ofro kushte me të mira, prandaj për projektimi e një projekti të tij që konsideroj është mjaft kapital për Komunën e Vitisë dhe për vet qytetaret e Lubishtës, ka aty që korrigjohen i jepen vërejtje dhe mund të shtyhet ajo çështje, prandaj unë nuk e konsideroj që është kumedit çfarë pyetje e cila nuk ka rëndësi a ka dal tenderi të hënën a ka dal të premtën. Unë e konsideroj e mirë dhe e arritur është që me u asfaltua rruga e Lubishtës, rrugë e cila edhe e meriton për shkak se është tej mase e dëmtuar. U ngrit edhe një çështje tjetër me të cilën jemi marr në bukur shume, duke fillua prej ditës së premtë dhe dje është fjala për pishat

për fshatin Terpezë. Fillimisht dua që të ju njoftoj ashtu qyshe edhe unë mendoj edhe ashtu qyshe është e rregulluar me ligjet që janë në funksion nga shteti i Kosovës, pishat janë në territorin e Terpezës, janë në territorin e Komunës së Vitisë. Pyjet janë pasuri nacionale, duhet ta kemi të qartë këtë, duhet ta kemi të qartë se për ruajtjen e pyjeve kompetent është komuna, për menaxhimin e tyre është Agjensioni i Pyjeve në nivel të Kosovës, pse janë ligjet e tilla as një prej juve nuk jeni fajtor, nuk jemi fajtor as na, janë ata të cilët e kanë rregulluar në atë formë, prandaj në bisedë të cilët na kanë njoftuar qytetaret e Terpezës se po ndodh në këtë formë, kryetari i Komunës së Vitisë ka marrë vendim dhe të njëjtën ditë, të Premten i ka dërguar dy drejtorë, të cilët konsiderojmë që janë me të afër me problematiken, drejtorin për Bujqësi dhe Pylltari dhe Drejtorin e Inspeksionit, dhe ka dhënë urdhër që të ndërpritet prehja e pishave deri sa të sqarohet ajo çështje. Ajo ka ndodhë dhe dje kemi pas takim se bashku me dy drejtorët që ishte edhe kryetari i Komunës, kryesuesi, qytetaret, përfaqësuesit e qytetarëve të Terpezës, Këshilli i Fshatit Terpezë dhe drejtori i Regjional, që ishte për çështjen e pyjeve, që fatmirësisht ishte nga Komuna e Vitisë. Çështja planin të cilin ata e kishin në plan ta realizojnë e kanë bërë gjashtë ekspert të pylltarisë, të cilët unë kërkoj mu përzi në çështjen e profesionalizimit të kote, muji mi thanë ndërpre, mirëpo që muji mi thanë e kemi bërë keq apo mirë nuk muji, ngase që ata janë me profesional e din edhe pasojat në rast që nuk bëhet ajo i din edhe të mirat do të i din kërkoj. Në atë aspekt dhe është biseduar dy orë lidhur me këtë çështje dhe kërkoj në përfundim kemi ardhur që ajo çështje të ndërpritet të shikohet se a ka mundësi të ndryshohet dhe të bëhet krasitja e këtyre pishave, diku në largësi prej 3-4 metra dhe të shikohet mundësia alternative jo se për shkak me tepër ka qenë problemi pse ka ndodh pikërisht aty, aty ku pishat të kokën me të zhvilluara që mund të ndodhë, megjithatë plani si plan kur është bërë dhe në aspekte ligjore të cilin e shpjegon drejtori i cili është shumë profesional në atë çështje. Gjithkund në botën perëndimore, botën demokratike, të cilët e kanë pyjet të ruajtura shumë mirë ato ndodhin dhe po ndodhkan për shkak zjarrvëmjes, të cilët mund të ndodhin dhe këtë model ky model është jo vetëm për Komune e Vitisë, është duke filluar prej Kamenicës, Ranillugit, Gjilanit dhe Vitisë, dhe në të gjitha pyetjet të cilat janë ushtruar në atë drejtim, pse pikërisht në Terpezë dhe të pishat për shkak të vlerëshmerisë të pishave, të cilat e kanë me të madhe dhe duhet intervenimi sa më shpejtë aty, megjithatë në e kemi ndërpre për momentin punën dhe do ta shikojmë çështjen e cila është me e mirë e mundshme për ruajtje e atyre, megjithatë në rast se i pyet ekspertet, të gjithë tregojnë se ata e kanë pasur me të drejtë, por megjithatë ende tek në nuk është e zhvilluar çështja se si duhet të rregullohen dhe prandaj ndodhin këto reagime. Çështja tjetër e ndoshta pa e theksuar me emër, por po dihet se është fjala Mirlind për ty, është fjala duhet me qenë shumë parimore. Unë e shtroj shumë herë pyetjen, athu Terpeza ka udhëtojnë, a shkon në punë ata a shkojnë në shkollë, apo lëvizin, prandaj kërkoj me thanë që është një rrugë e cila është dëmtuar unë pajtohem se është në atë formë është, por po bëjmë përpjekje që të mënjanohet edhe ajo bile kemi marrë garancion për sajimin e kësaj rruge, nuk kemi nejtë duart kryq, megjithatë ajo breng sa është e jotja banvaki e jona është edhe 100% me shume dhe vazhdon të jetë që me të vërtetë të gjitha ato para publike që janë para të qytetarëve të Komunës së Vitisë të investohen dhe të rregullohen në mënyrën me të mirë të mundshme. Shkolla e Stubllës nuk e kemi në plan të prokurimit, ato janë 25 mijë euro donacion, 25 mijë janë nga ana e Ministrisë, 3 mijë participim Komuna edhe është 28 mijë, e kemi edhe drejtorin këtu, po kjo është saktësisht, dhe ndoshta fal atyre raporteve të mira të qeverisë komunale ka arritur edhe nga qeveria që unë besoj që duhet me të gezuar kjo, ki me pas edhe shume projekte tjera që nuk i kemi në plan të

prokurimit, por te cilat kanë me ndodh ne Viti banvaki shifra arrin 1 milion e tepërt. Samia mu dok lypi rrugë alternative, qe ka ku, unë pajtohem. Bekim Azizi e di qe ne gjimnaz kanë dal dy profesor, mos thua me nga dy tre muaj se njërin e kam vendas qe shume me frik ka dal pension tjetri ka dal dje a pardje. Në Pozharan nuk e di, nëse e ki fjalën për Sherifin dhe Femi Alidemen, po ti thamë me emra, janë shume frik te dytë qe janë dal ne pension, të cilët kanë qenë mësimdhënës ne gjimnaz. Praktiken qe e ndjekim na po edhe qeveritë tjera për mos shpalljen e konkurseve, por ata te cilët kanë konkurs e qe thonj qe është ligjore, që edhe unë besoj qe është ligjore, e te cilët vinë me ren se edhe te shërbyesit civil mund te veprohet ku ai i cili është me rende nëse është pranë një kandidat vjen ai i cili është masë tije dhe ne këtë formë besoj qe e ka bërë zëvendësimin edhe pse kurrë nuk jam marr me këtë punë, besoj që është çështje e Drejtorisë së Arsimit, megjithatë unë do ti thamë drejtorit që është kërkuar një përgjigje nga ana e këshilltarëve dhe ne seancën e ardhshme pikërisht do ta kishe prej drejtorit besoj përgjigjen, besoj që ndoshta ne këtë formë e ka bere, pishat tregova, për te qenet endacak i kemi marr edhe ne disa masa për te cilat besoj qe edhe ti je ne dijeni. Është e vërtet qe ka shumë, po bëjmë përpjekje qe krejt ato me te vërtet ta pastrojmë Vitin dhe territorin e komunës. Nga qentë endacak është fati i mirë qe nuk ka ardhur deri te një e keqe qe ka mujt, mund me ndodhë, por megjithatë ne Viti deri tash nuk ka ndodhe dhe dhashë Zoti qe mos te ndodhë. Listën e rrugëve rurale, unë besoj ajo ka qenë edhe përmes tenderit, ki me pas, hiq nuk është problem edhe këtë ki me pas edhe ki me pa cila rrugë shtrohet. E di qe një kompani e cila na ka gëzuar neve, besoj qe ju gëzon edhe juve, një kompani shume serioze e ka fitu këtë tender, është fjala për papemburgun qe është dëshmuar deri tash si kompani me e mirë dhe i urojmë që ti përfundon sa me shpejt dhe me te vërtet qe ai plan te cilin e kem të realizohet dhe sidomos punëtorët tanë në botën e jashtme qe janë kur te vinë ti shijojnë ato te mira te cilat po i sjell qeveria komunale. Nuredin e di qe vitin e kaluar është pajis çerdhja ne qeshjes e inventarizimit te objekteve shkollore, tash nuk e di për këtë vit është pyetje konkrete, megjithatë do te bej përpjekje ta shikoj a ka hi, në rast se me te vërtet ka asi gjendje do ta shiqojmë formën, megjithatë duhet te shiqojmë se a ka hi se ai objekt hyn ne objektet edukative-arsimore, qe i bjenë dhe a ka hi a nuk ka hi nuk muj me te than se nuk e di saktësisht. Sllatinën e përgëzoj për te gjithë ata qe ka bërë dhe besoj qe atë model bën me marr edhe fshatrat tjerë dhe me ndjek ka qen me herët edhe Goshica edhe shume lokalitete tjera për pastrimi e lokalitetit te tyre edhe deponimeve te egra, është e vërtet se ndoshta forma me e mirë e mundshme për momenti është kjo forme se ne rast se secili e japim nga një kontribut do ta kem Vitin edhe Kosovën ndryshe edhe ne aspektin e ambientit. Bislim, ky Kuvend, ju e dini qe kem bërë përpjekje te vazhdueshme me DEMOS, e ku e kemi bere një plan te mobilitetit te aprovuar nga ana juaj, kemi filluar diku disa hapa te vegjël ne dukje, por qe janë hapa te mëdhenj ne aspekt te rregullimit te komunikacionit edhe atyre pjerrinave te cilat i kemi bërë se bashku me DEMOS-in për personat me aftësi te kufizuar dhe kështu gradualisht fillojmë implementimi e ati plani, qe konsideroj është shume i mirë. Çështjen e kualitetit, me siguri ka edhe mbikëqyrje se nuk ka projekt i cili nuk ka mbikëqyrës, munde ta përcjellim shqetësimi tan mund me ndodhe me gjithat përpjekjet maksimale kemi mi bërë qe me te vërtet ato te jen te qëndrueshme, por megjithatë po jetojmë ne Kosovë e ne Viti, mund me ndodhe ato sene ne si qeveri komunale përpjekjet kanë mu bë maksimale se bashku me juve qe me te vërtet ta ndryshojmë Vitinë për të mirë e për te mbarë, duke filluar prej rregullimi dhe sinjalizimit horizontal dhe vertikale e krejt

ato tjera te cilat janë te mundura. Ju faleminderit shume, këto ishin ato te cilat ju i parashtruat, unë do te jem pjesë e juaj deri ne përfundim te Kuvendit.

Drejtori z.Skender Ahmeti: Faleminderit Kryesues, përshëndetje për juve, përshëndetje për Nënkryetarin, për Deputet dhe për koleg drejtorë!. Unë dola, jam pak i emocionuar se normal ato pisha te cilat i përmendi deputetja janë pjesë që i takon me se shumti Terpezes, jam kanë i shqetësuar, gjatë këtij vikendi, gjate ditës se Premte, të Shtune, te Diellen e deri dje ky shqetësim është shqetësim edhe i qytetarëve te Terpezes, te cilët përmes është koorporu edhe në Qeverinë Komunale. Krejt ato që i tha nënkryetari është kjo, ajo që e tha nënkryetari është realisht qashtu kem veprua. Unë dola pak me tepër me i përshëndet qytetaret e Terpezes, për këmbëngulësinë e tyre për mi ruajte pishat, do të thotë atë vende, atë Prevallë atje naltë. Natyrisht e përkrahi edhe kryetarin e Komunës që ka qene ne shërbim te qytetarëve dhe interesave te tyre dhe ka marrë vendim për me mbrojt at vend, nuk po e kontestojë çëshjen e planit operativ te Agjencisë Pyjore të Kosovës, që të hapet disa korridore për mbrojtje e atyre pishave nga zjarri, por ajo sipërfaqe ne te cilën është hapure korridori është dikund rrethe trembëdhjetë hektarë dhe një korridor me 30 metra gjerësi ne ato pisha me te zhvilluara te fshatit te asaj pjese katastrale, në at zone është shume humbje e madhe dhe publikisht thamë se është një krim i madhe edhe ekonomik një krime i madhe edhe ambiental. Prandaj u dashtë te qohen ne kam jo vetëm qytetaret e Terpezes, por krejt masa për me mbrojt ato pisha, por këtë gjendje ja kam transmetua drejtpërdrejt kryetarit te Komunës, i cili me ka urdhërua mu se bashku me drejtorin e Bujqësisë që te dalim ne vendin e ngjarje dhe që ti ndalim punimet dhe i kemi ndalë ato punime. Po në aspektin profesional unë e di që ekspertët e pyjeve janë me përkatës për këtë pune, por edhe ne jem me afër pyjeve edhe ne mendojmë që pa pasur strategji tjera pa e kontestua qëllimin e mirë te tyre për mbrojtje nga zjarri ka mundësi që te behet pastrimi sanitar i atyre pyjeve ne distancën që e përmendi nënkryetari, në lartësi 3-4 metra, pjesën vertikale dhe pjesën tokësore te atyre kraneve te thata dhe mburojave tjera që janë aty me u pastrua edhe ajo ka qen mbrojtja me e mirë kundër zjarrit, prandaj ne ballafaqimin e djeshme edhe me Agjencionin e Pyjor të Kosovës e kemi kontestua dhe unë mendoj që nëse ne aspektin ligjore ata kane pas te drejtë, unë mendoj që ne aspektin e dëmtimit te pyjeve kane përgjegjësi, prandaj kanë edhe përgjegjësi ligjore publikisht po e thamë këtë, edhe një herë dëshiroj që ta falemenderoj kryetarin e Komunës pa kurrfarë implikimi politik për masën që ka dal na ka përkrah, por natyrisht publikisht i falemenderoj qytetaret e Terpezes, te cilët janë kane me çdo kusht dhe me çdo mjet për mbrojtje e asaj pasurie, prandaj edhe një herë faleminderit qytetar të Terpezes.

znj. Mirlinda Sadiku, a është dashur te ndodhe çekja jo normal nuk u dashtë te ndodhe Vitia është shpija jone nëse nuk e mbrojmë na kush ka me mbrojt me vjen shume mire që vetëdija e njerëzve po mendoj fshatrave te Terpezes është ne at nivel që kanë dal i kanë mbrojt këto pisha se këto nevojitet kogjo një kohë e gjate për mu rrit për me mëri këtë lartësi a duhet mu pre 200 druj për mu hap një hapësi brenda un nuk jam eksperte e kësaj fushe sa i përket asfaltimit te rrugës Lubisht kryetar ndoshta me keq kuptove ne plan te prokurimit është me dt: 01.03.2016, ndërsa u publiku me dt:04.05.2016, dmth me dy muaj vonesë, por me gjithat nga fundi po kryhet punët shkel e shko edhe na ndodhe rasti sikur ne fsh. Terpeze ku aty është tu arnu aj asfalt ka njerëz te cilëve ju kanë dëmtua veturat ne fund shkurt un kam prit edhe znj Vjollca ka me ngrit si qeshtje pasi që vjen nga aj lokalitet për deri sa jemi ne viti 2016, ne mesin e muajit te vitit 2016 pse mos me ngrit si qeshtje se tek e fundit është lokalitet që e

meriton me pas një asfalt te mirë një rrugë te mirë se janë taksa pagues te kësaj komune sikur qe e ka psh fsh. Zhiti pse nuk po thamë për fsh. Zhiti, edhe sa i për ketë për shkollën me bahet qefi qe pas 16 ose 17 vite i ka kthyer sytë qeveria edhe nga Vitia por sipas institutit GAP ju e pat qe është e diskriminuar Komuna e Viti-së qoftë nga Ministria e Infrastrukturës, qoftë nga Ministria e Arsimit .

znj.Vjollca Kadolli-Halili: Përshëndetje për Nënkryetarin, Kryetarin e kuvendit dhe ju te pranishmit te tjerë. Faleminderit Mirlind qe po ma kujton e kahit jam, por nuk e harroj kurrë, edhe pse kam prejardhjen prej largu, por nuk e harroj qe edhe Terpezes, por dallimin ne mes meje dhe teje ne ketë rast është, se unë nuk kam prit çdo seancë, d.m.th një herë ne muaj për me reagua për ketë çështje, por kam reagua çdo dite te kryetari, qe ku është edhe nënkryetari, është drejtori, kryesuesi i Kuvendit, janë fshataret e Terpezes, është kryetari i këshillit te fshatit qe kemi biseduar, shumë herë kame qen ne vend te ngjarjes bashke me kryetarin e këshillit te fshatit, është diskutua edhe ne zyre te kryetarit për ketë çështje edhe jam kanë muj me than te paktën jam kane 30-40 takime, ku unë personalisht qe kam marre pjesë, që kem diskutuar çështjen e Terpezes, që ma merr mendja qe ti e ki ngrit vetëm dy herë ne Kuvend. Ky është dallimi në mes meje dhe teje. Sa i parket aty kualitetit qe diskutove, për kohen se kur është ndërtuar ajo rruga ka pasur për shkak këtyre tenderëve qe thave, ka qenë me vonesë qitja e tenderit nuk qëndron fare, sepse ne te njëjtën ko heshte ndërtuar edhe rruga e Zhitis edhe rruga e Budrikes, qe janë shume mirë, kam qen ne ato dy rruge, por fajin nuk janë tu mujt me gjete as ekspertët çka ka ndodhë. Dyshohet shume ne kualitetin e ngjeshjes qe ka ndodhë, ndoshta me shumë ose vetë betonjerkes, nuk di kam bisedua edhe me disa ekspertë qe ma kanë përmend një shprehje qe ka mujt me qene fajtor, qe nuk janë tu i ra ne fije, aq me pak qe unë si mjeke ose ti si profesoreshe, kështu që të lutem te jesh pak me konkrete edhe mos me gjuajt shumë, se ata qytetaret e Terpezes e dinë shume mirë, nuk ka nevojë përmes televizionit me i shfrytëzuar shancën.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Arsyeja e daljes është, mua me pengon aj fjalori ta mbrojmë me pengon edhe i drejtorit qe ne e kem emëruar me mbrojt e mbron komuna e mbron qeveria, nuk e mbron as Remniki as Terpeza, nuk ka këtu anarki, duhet ta keni te kjart e mbron komuna, ka zot shpije, ka kryetar komune, i ka këshilltarët e Kuvendit Komunal, ka Qeveri Komunale, nuk munde me mbrojt kërkush, nuk jem ne kohe te lufte, është keq para mediave te informimit me gjuajte fjalor ne do te mbrojmë me çdo mjete. Duhet ta kem te kjart, e mbron kryetari i komunës, i ka mekanizmin se bashku me juve dhe qashtu mbrohen pyjet, nuk mbrohen tu than faleminderit ati faleminderit këtij, pyjet mbrohen me veprim konkret dhe veprimi konkret është bërë, janë ardhur edhe ata nuk janë institucionet qendrore armiket tona, ketë duhet ta kuptojmë sikur qe ju qe jeni dal prej votës se popullit edhe ata janë dal veç qe ata janë te nivelit qendror na te nivelit lokal, prandaj ju lutem te ruhem i prej atyre çështjeve. Çështja e rrugës së Terpezes, veç po me vjen shume keq te cilët me te vërtet po gjuheni, thash edhe ne fillim ne forme me te keqe te mundshme, a je kanë najë here me pyet ne qeveri komunale sa takime te progresit janë bë dhe sa është numri i dokumentacioneve te cilët janë ma në mënyrë ndërsjellët, jo, d.m.th edhe mbikëqyrësi qe është prej komunës edhe kompania e cila ka ardhur në vendin e ngjarjes me familje e vete deri edhe prindi i vet e ka pa qe me te vërtet ka ndodh diçka jo e zakonshme aty, cilët janë arsyet ingjinerat e dinë me mirë, a është mungesa qe nuk ju kanë qite te gjitha elementet asfalti a është mos ngjeshja është çështja e tyre. Rruga e Terpezës dimrit nuk është bërë pikërisht ne korrik e ngushe kur është koha me e mirë e mundshme, prandaj nuk

duhet te lidhemi me ato çështje te koka nam i madhe nëse ka qen me 1 marse mu shpalle rruga Lubisht dhe te koka shpalle me dy muaj vonesë, ma ju lutem këto duhet a planet te cilët kërkohen shume shumë etapa te kalimit, tu filluar prej plani idior, planit kryesor, ndoshta intervenimi aty këtu te përmirësimit, të revitimit te ati plani munde ta shtynë, është me rendësi ju si këshilltar te Kuvendit Komunale jeni përgjegjës me than kjo qeveri komunale e ka fute ne plan dhe nuk e ka realizuar brenda vitit 2016. S'je aprovues te ati buxheti, po jo edhe ne formë një muj me herët një muaj me vonës, sun jam dal, këto pisha shume tu paskan dhimtë ty, Këshyre, të jemi shume korrekt, unë nuk muj me ju tha atyre te Agjencionit të Pyjeve, dje ju kam than ne formën tjetër, por juve po ju thamë tash nuk muj me than qe ata janë me pak shqiptar se Hasan Alia, as ma pak qe e donë Kosovën dhe Vitinë, por megjithatë e kanë paraparë ne qatë forme tash e kem ndërpret te cilët kanë thanë ne rast qe ju na thoni me ndërpre na e ndërpreme, nuk ka problem, edhe ne e kem thanë ndërprehe, është disponimi i qytetarëve me ndërpre e ndërpreme, i këshyrmi format tjera, pro me gjithat ky ingjizim dëgjohep nëpër diku tjetër dhe ai njeri dje ka qenë pikërisht i agjencionit pro qeverisë, pra neve e ka dëgjuar edhe zërin e qytetarëve, tash ne rast qe dëgjon qe ne kem me mbrojt na e kem mbrojt çfarë fjalori është, ju lutem të jem me korrekt. Ju faleminderit!

Kryesuesi z.Naim Pira: I falënderoj te gjithë parafolësit dhe deklaroj që në seancën e -V- të kemi parapare këtë:

R E N D I T E

- 1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt e Kuvendit Komunal të Vitisë.**
- 2. Propozim vendim për përcaktimin e lokacioni për ndërtimin e objekti të zjarrfikësve.**
- 3. Propozim vendim për hartimin e Planit të Veprimit Lokal në Mjedis.**
- 4. Raport mbi vlerësimin e kushteve për dhënien e pëlqimit për leje të nderimit.**
- 5. Propozim vendim për rishikimin e buxhetit komunal për vitin 2016.**

A ka dikush rrethe rendit te ditës ju lutem?, pasi qe nuk ka hedhet ne votim për miratim i rendit të ditës: Kush është për miratim, konstatoj qe me votat e te gjithëve u miratua ky rend dite.

Pika e parë

Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt e Kuvendit Komunal të Vitisë

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat rrethe procesverbalit: A ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim. Pasi që nuk ka, hudhet ne votim: Kush është qe te miratohet procesverbali i mbledhja e katërt e Kuvendit Komunal Vitisë? Nga te gjithë asamblastët prezent pika e parë u miratuar.

Pika e dytë

Propozim vendim për përcaktimin e lokacioni për ndërtimin e objekti të zjarrfikësve

Kryesuesi z Naim Pira: Kërkoj nga Drejtori i Katastrit që te jep arsyetimin e propozim vendimit, ku kryesuesi i njoftoj qe ne Komitetin për Politik dhe Financa është kërkuar kopja e planit fizik e ku është shpërnda sot ne fillim të seancës.

Drejtori z.Mufail Halabaku: Faleminderit kryesues! Është hera e parë e imja qe dal para jush, por prandaj po kërkoj falje qe nuk muj mu kanë emocionalish bashe korrekt. Të nderuar këshilltar komunale, para jush kam një propozim vendim te rëndësishëm dhe shumë të nevojshëm për Vitinë, i cili ka te bëjë me caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit te zjarrfikësve, vend lokacioni i propozuar është në parcelën me ndërtim te objektit me nr. 2496

ose 2496/5 ne zone kastastrale, konkretisht mbrapa stacionit të autobuzave. Ndoshta si vend lokacion nuk është i përshtatshëm po është për arsye se prona ekzistuese, mirëpo besoj që ju jeni në dijeni që ajo parcelë ku sot janë zjarrefikesat është pronë e AKP-ose e “Agromoraves” edhe menaxhohet nga AKP-ja. Ndërtimi i këtij objekti të zjarrefikesave dhe ndërtimi i objekteve përcjellëse se është investim i qeveris se Republikës së Kosovës, d.m.th para se të merren hapa tjerë nga ne është kërkuar që përmes Kuvendit Komunal të Vitisë të caktohet lokacioni. Mendoj që rreth kësaj çështje shtesë mund të jep edhe nënkryetari i komunës z.Hasan Alia gjithmonë nëse është nevoja. Bashkangjitur këtij materiale e keni edhe një foto me flet poseduese edhe një kopje të planit, të cilën e ka shpërnda sekretaria. Ky është një arsyetim në pika të shkurta, andaj nëse keni ndonjë pyetje ose paqartësi ju lutem urdhëroni. Ju faleminderit!

z.Sejdi Emini: Përhëndetje për të gjithë të pranishmit! Ne e kemi dhënë një propozim të tillë kahë moti, e dini që janë bërë edhe dy tri debate bukur të ashpra për këtë çështje, edhe pse është me vonesë, megjithatë ja vlen. Ka qenë kërkesë e kamotshme e tyre, që me pas një lokacion, sepse e dimi që është edhe hup edhe grande, pikërisht për shkak të këtij lokacioni, unë mendoj që edhe vendi ku është nuk është i keq, është i përshtatshëm, mirëpo ajo që më shqetësoj pak me herët, po lidhna me atë që po i ikim përgjegjësisë. Përgjegjësisë mos ti ik kërkuar, kush do që a, ai ka përgjegjësitë, le ti mban qyshe po i marrim privilegjet le ti marrim edhe përgjegjësitë për demet që i kemi, kjo është me vonesë, prapë po thamë kem përgjegjësi pse jem vonuar, sepse kemi hup grande edhe u kanë kërkesë e shume zjarrefikësve dhe jemi kanë zë të tyre.

z.Daut Xhemajli: Përhëndetje për të gjithë! Pavarësisht prej asaj që komiteti kam menduar që nuk është vendi me adekuat, në si komitet kemi mendu ose kemi propozua, kemi kërkuar që materiali që e kemi pas me ndryshuar edhe me naj pru në Kuvend konform asaj që me një formë Ishmi dakord. Problemi është drejtori, nuk i japë as një faje zyrtarëve të kësaj drejtorie. Unë mendoj që janë përgjegjës kryesor pse najë kanë pru këtë flet kështu. Propozim vendimi duhet me përshkruar edhe fletën edhe parcelën edhe ndarje edhe krejt këto gjana sipas meje kjo flete e ndamë është absurd, është katastrofë, sepse shikojë vetëm qyshe është kufizua ky objekt, që me një fort shfrytëzohej që 17 vjet pa leje pa as një cent, nuk pagunë kush, pra, qysh është nda edhe janë do numra në propozim vendim, nuk janë unë. Mendoj dhe propozoj që sot drejtori me stafin e tij duhet me kthye këtë propozim vendim me shku atje me mate gjendje ekzistues qyshe është, se jam dal, unë e kam pa vendin e kam pa viziolisht, ekziston mundësia me vendos, por kështu me nda është për mua apsur, pavarësisht se mundet të jete si formale, ku e vendosi e tjera, ama kështu me nda sipas meje është absurd, sepse këtu një qoshe, këtu shihet ai objekti i qendrës së banimit social, nëse nuk gaboj se nuk është në tërësi, unë propozoj që kjo si tersi si parcelë të shikohet nga ekspert që i ka komuna, të mendohet aty pari që mund me qen edhe naj objekt social në pjesë afër edhe prej objekti deri të ky këndi i këtij objekti, që është i përkohshëm, ta zëmë me beton, në thojza po thamë, se nuk ka objekt të përshohem me beton, mundet të ndahet por drejt nga lumi edhe kjo pjesa tjetër të mendohet mendje për stacionin e autobuzave që Vitia nuk e ka edhe që Vitia me një formë kështu ose qyshe dojnë ata pronar të autobuzave e shfrytëzojnë etje etj edhe Vitia duhet me pas një kompani të kësaj natyre. Nuk e di pse nuk e ka deri tash Vitia këtë, edhe pse janë bart kompetencat e komunave, por prapë Vitia nuk e ka këtë përgjegjësi pse nuk e merr, por mbi të gjitha unë kërkoj që debat të mos këtë ma për këtë punë edhe të kthehet të ndahet saktësisht kjo parcelë dhe të ndahet ashtu qyshe mundet me pas, d.m.th konform vendin edhe konform asaj hapësire, tu e mendu edhe objektin e banimit social, tu e mendu edhe stacionin e autobuzave, që ndoshta me një periudhë të shkurt duhet të rregullohet në këtë pjesën tjetër. Këta numra këtu që nuk janë në propozim vendim pa përshkrim janë absurd, që nuk ka kuptim hiq me biseduar për këtë. Ju faleminderit!

z.Samet Idrizi: I nderuari kryesues, nënkryetar të nderuar koleg asamblist, të gjithë të pranishmit, përhëndetje. Kulmi i kësaj pike po dijet, unë do të jem i drejtpërdrejt ku unë

personalisht vendi me duket pak i përthyer, se çështja është shumë e ndjeshme e organizatës, e cila merret edhe shpëtim të jetrave, përveç shuarjes së zjarrit, mu diqysh lokacioni po me duket shumë, duhet deri sa të drejtohet ato makineri të mdhaja, me dal në rrugë kryesore e ku nuk ka rruge alternative. Kisha propozuar mundësinë, megjithëse komuna ka analizuar çështjen, me gjet një lokacion tjetër ku kemi minimume dy rruge alternative, rruga aty mbi VINEX-in, shpesh, se unë udhëtoj aty mbi 11 vite për Gjilan e që shpesh në at rrugë bëhen kolona, ashtu që mund me ndodh që automjeti i zjarrefikesve tashti ka thirrje dhe po provon me dal në rrugë kryesore dhe mu qase për me bë shërbimin për qytetar, mundet me mbete për shkak të kolonës, që ndodhin shpesh dhe në moment aty mund mu bë naj habi edhe me ndodh edhe një aksident tjetër, para se me shku me krye shërbimin e qytetarëve, kështu që le të shikohet mundësia edhe një herë e një lokacioni tjetër me të favorshëm, unë nuk di a ka mundësi me bë një lokacion të kjo pjesa, të fusha e sportit, mos është më mirë, ka mundësi me qene këtu një rrugë ka Vitia, një ka Kabashi, tashti aty ka rrugë alternative qyshe është mundësia me pa. Ju faleminderit!

znj.Vjollca Kadolli-Halili: Ato të cilët i diskutuan parafolësit në aspektin profesional, sidomos Dauti, se ajo që janë propozuar, a janë mirë të shkruara apo jo nuk muj të them kurrëgjë, mirëpo ideja që të ndërtohet një objekt i ri për Njësinë e Zjarrefikësve, në si LDK jemi shumë pro, mendoj që është e qëlluar, sepse shumë herë është ngrit çështja e zjarrefiksave për shkak kushteve që janë, prandaj në jemi në përkrahje të këtij propozim vendimi.

z.Ali Bajrami: Përhëndetje Kryesues, Nënkryetar, Këshilltar Komunal, Drejtor, media të shkruara dhe elektronike e OSBE!. Ky propozim vendim që e kem para vete nuk është ndoshta me i miri i mundshëm, por është me i miri që na bënë zgjidhjen për momentin, se lokacion tjetër që është pronë e komunës nuk kem, tu i din krejt problematikat e Komunës së Vitisë që i kem me AKP-ne. Vetëm të nalemi e të mendojmë se çfarë përgjegjësie po marrim, nëse nesra ndodh që lokacioni ku janë i largojnë prej aty, ku do të qojnë zjarrefiksat, prandaj ndarja që është bërë, vendi ku është edhe donacioni që është prej Ministrisë së Punëve të Brendshme. Unë nuk jam që kjo të zhagitet, që kjo të prolongohet për seancat tjera, se koha po kalon, se nënë stop tani po kemi vërejtje se po shtyhet me qëllim procedurat e tenderimit e me ardhë koha mu krye punët shkel e shko, pikërisht këto janë me zanë hapin edhe me krye punët me të mirë të mundshme. Unë jam për këtë propozim vendim, që të kalon edhe të bëjmë një zgjidhje për një kohë me të gjatë, pse nëse kem mundësi me gjete një lokacion me të mirë muj ta ndërrojmë, për momentin është ky. Ju faleminderit!

znj.Mirlinda Sadiku: Jam shumë e vetdijshme se sa kam pas biseduar me zjarrefiksat para dy vite kanë hup një donacion nga Republika e Kroacisë në lidhje me ndërtimin e një objekti, mirëpo ajo që na u ka sjell në Kuvend është vetëm ky lokacion dhe jo asnjë tjetër opcion edhe atë ditë e kam shpreh një dyshim në mbledhjen e Komitetit për Politik dhe Financa, tu e ditë që aty ka një fluks të madh, nxënësat 9 muj sa shkojnë shkolle po ashtu edhe kyçja në rrugën kryesore ka një fluks të madh të veturave, sepse sikur ta kishim një listë, p.sh. vendeve lokacioneve që do të na propozofshin, me kujtohet shumë mirë që zonja Selvije Rexhepi ka kërkuar para dy vite, nëse nuk gaboje, për pronat të cilat janë në pronësi të komunës po të kishim ndonjë opcion tjetër do të ishte shumë mirë. Zotri Dauti e ka propozuar atje të palestra sportive ku po dertohet, d.m.th edhe unë shprehi një dyshim se nuk është bash vendi i qëlluar, nuk është për hirë të një donacioni ta bëjë një zgjidhje shpejt e shpejt, sepse ajo bien e aty do të jetë me vite. Ju faleminderit!

z.Bekim Azizi: Faleminderit Kryesues! Unë po flas, po e bëj një krahasim në mes të propozim vendimit të parcela 2496-1, ndërsa qetu 2496-1 nuk ka hiq, nuk ka, nëse dikush e dine ku është tu e nda qet parcelë 2496-1 edhe e gjanë në qete projektin që një kanë pru, atëherë e bëjmë qyshe dush, mirëpo qetu - nuk kemi. Tjetra, nuk e di qyshe ka mundësi e njëjta parcelë që u nda e ka pas që na ka ardhur në komitet 2496-1, kjo ka hup krejt, tashti që saj parcele i kanë hup numrat, nuk e di qysh ka ndodhe kjo nuk e di qyshe e bëjnë ata ekspertët që janë atje, çka guzojnë me bë edhe këtë shkelje me na ndërruar edhe numri e parcelës. Kjo nuk

guxon me ndodhe hiq. Tjetra, ne po flasim për pjesë ku është stacioni i autobuzave 50 ari, ose 5 mije e 9 metra. Qeto 5 mije e 9 metra tash me qet qe i ka ndan -5, d.m.th diku 2 mije e 81 m², sa ka mete stacioni i autobuzave, po edhe 50 ari për stacion te autobuzave nëse mendojmë me lan aty janë pakë. Ai vend qe vendoset, qe është dash stacioni i autobuzave qe nuk ka metë ma as vend për stacion te autobuzave, ai vend qe ka metë mbrapa qe parashihet tash për objekti kërkushë sa kundër objektit te zjarrefiskve krejt jem tu diskutua qe sa kohe me bë një vend për zjarrefiska. Qetu nuk ka mundësi, kyçja ne rrugën kryesore është e vështire, dalja prej këtu është e vështirë, dalje alternative nuk ka, është intervenim emergjent, intervenimi emergjent duhet me pas rrugë qel jo mshel, ne këtë pozicion rrugët janë mshl, edhe mendoj qe është vend i gabuar, nuk është vende i mirë, nuk ka qasje të lehtë ne komunikacion, plus nuk është e sqarume hiq qe vendimi të cilin e ndanë. Në këtë propozim vendim nuk e dimë, nuk dimë qe ku e dajmë këtë tokë, d.m.th qe nuk muj me votu këtë propozim vendim. Ju faleminderit!

z.Sejdi Emini: Kur e thashë ne fillim qe përgjegjësi duhet mi mbajt secili për kohen kur qeverisim, është koha kur edhe Dauti ka qeveris ne dy mandate edhe nuk u dashtë me najë lëne këtë far pune hiq. Sot këtu u dashtë mu harru kjo punë se ka qene kërkesë e kahëmotshme e kësaj pune, por nuk po thamë qe edhe këta nuk kanë përgjegjësi qe e kanë zhegit qe dy vite, edhe këta te njëjtën përgjegjësi e kanë, atëherë besoj qe nuk është bashkë mirë me bë një far politike te dy fish, po duhet me kanë fer, kushto qoftë në qeveri të kalume, qeveri e tanishme ta marrim përgjegjësinë, te mësom me marr përgjegjësinë për fajin qe kemi secili ta marrim për veti. Diqysh nuk po mund me u pajtu, nuk po muj me heshtë, edhe ti Samet ki qeverisë, ne jse Dauti, por edhe këta kanë përgjegjësi, se nuk është kërkesë e sotit qe po lindë edhe ka pas kohë mu mëndu për vend e për alternativa për te gjitha këto ka pas vend me mëndu mos me na pru ne këtë pozitë te palakmueshme kur ne e ngritshim këtë ju heshtet, ju doke qe është një sen shume i letë, sot po del qe nuk është shume i letë, po del qe është shume i rëndësishëm.

z.Daut Xhemajli: Nuk dola për replikë se nuk ka nevojë, mendoj qe kuptohemi drejtë, se me u pas vete unë, pronat e komunës nuk i kishe marrë AKP-ja, edhe nuk ishin trafiku e nuk ishin bë hiq këto sene qe po ndodhin këtu fare, por problemi është qe ne kemi luftuar me qeto çka i kemi dhe qysh i kemi. Propozimi im është i kjart, nuk jam kundër, d.m.th qe këtu te ndahet se ne kemi fol ne komitet, nuk deshëm mi përsëritë, se ideja ka qene edhe ndryshe, ka propozime edhe ndryshe, propozimi sa me rendësi, por problemi është kjo ndarje nuk është kuruar ndarje, nuk është kërkuar propozimi, prandaj thashë qe drejtoria bashke me ekspert tjerë ne kuadër te komunës te ulet edhe un muj me nimu nëse kanë nevojë, qe këtë parcelë me marr me qit ne gjendje reale, me u ingjizu edhe me bë ndarje, me bë një planifikim për këtë parcelë, çka po metët për stacion, çka po metët për objektin e zjarrfikësve në atë hapësirën edhe çka po mbetet e ka po orientohen ato objektet e banimit, eventualisht te reja ndonjë here. Problemi është qe kjo ndarje nuk ka kurrfarë ndarje, thashë drejtori nuk ka faj, as shpjegim nuk i kërkoj, se Bekim çdo ndarje qe behet ka numër, çdo ndarje masanej i shtohet numër i ri, por problemi është qe kjo nuk është kërkund me këtë edhe nuk kemi se çka me kërkuar. Nëse është urgjent, unë jam nesra e kryem këtë punë masnesra mblidhem si Kuvend edhe e ndajmë këtë pune e kurrjë kërkujt, por problemi është qe nuk ka kurrfarë ndarje, vetëm këshyrni vijat ka është bërë objekti nuk ka kuptim hiq, kjo kur te ndanë komuna e ndan objekti përgjysmë. Ky objekte ashtu kështu është i përhoshem, po ku hynë ku del çka bahet ne atë hapësinë, cila është ajo hapësin, sa metra, qyshe krej ato duhet mi qit ne letër edhe me nda parcele. Këshyre 2496-3, na e kemi një far hapësire qe e kemi marr si Kuvend, po kjo hapësinë atje ne vend nuk është çekjo atje, vendi është zgjeru se këta po dojnë edhe përreth “Moravës” me shku me shetit me zanë ven. Ata që e kanë bë at vend palidhje, është, d.m.th. un po foli se nuk kame dert hiq, për atë punë i hupet hapësira 3 me 4, 5 me 5, e bënë një hapësirë kumedit se çfarë, sikur qe është bahçja e babës, nuk është ashtu, edhe kështu që unë thash propozimi është ta shtyme ta orientojmë mirë ku është, ku mundet ti bëjmë vijat bashke me gjeodetet te bëjmë matjen edhe e kalojmë këtu nëse nuk ka alternativë tjetër, por qeshu jo. Faleminderit!

z.Adnan Imeri: Paraprakisht nëse kemi drejt edhe nëse mundemi për me propozuar me ndryshuar vendimin, kopja e planit edhe certifikata mbi te drejtat e parcelës, d.m.th është nxjerr me 10.05.2016, ndërsa kjo e reja sot që e ka ndarje fikse është e nxjerr me 23.05.2016, ku precizohet fikse, ku do te thotë se parcela për objektin e zjarrfikësve, d.m.th është 2496-5. Unë kisha propozuar, edhe sipërfaqja ndryshon, d.m.th prej 5009 m², ndryshon tash 2081m², gjithashtu vlen te cekëte se është afër qyteti edhe ja vlen edhe rrugën lidhëse e ka fikse. nuk është ne rrugën kryesore po me një distancë shume të afërt. Kisha propozuar që ne bazë te manualit te ri te ndarjes fizike tashti ta kalojmë këtë propozim vendime të përmirësohet edhe nr. i parcelës edhe sipërfaqja. Faleminderit!

Nënkryetari z.Hasan Alia: Fillimisht ju tregoj se isha prezent edhe ne mbledhjen e Komitetit për Politik dhe Financa. Konsideroj aty kryesuesi i Kuvendit i ka bërë këto sqarime, te cilat ju po i përsëritni sot, për shkak se edhe ne mbledhjen e Kuvendit ju ka kërkuar falje juve te Komitetit për Politik dhe Financa, se ndërkohë e ka qu edhe materialin dhe nuk ka pasë tani mundësi, prandaj mos te bazohemi pse kjo është se ju ka tregu edhe ne komitet se materiali për kuvend ju ka ardhë dhe krejt përfundimi i asaj ka qene edhe i juaji, konsideroj i pjese dërmuese anëtarë te KPF-së, që te behet një ndarje, bile te ju bihet në Kuvend jo si parcela si tërësi. Unë konsideroj konform ati propozimi te juajin u sjell edhe drejtoria, se nuk ka mujte me ardh ky propozim vendime me i nxjerr edhe mi përmirësu dhe e ka pru edhe ndarjen fizike, të cilën është kërkuar nga ana e juaj, për te cilën jem pajtua edhe unë. Dua mu ndal pak te çështja e pronave, që pronar i saj është Komuna e Vitisë. Nuk duhet ta fajësoj as një qeveri, e dinë Dauti se unë kam qenë në rrjedha edhe kur ka qene Dauti edhe kryetar krejt përpjekjet e Komunës së Vitisë kur i kemi bërë që ato te ndalen. Unë kam qenë drejtori i Gjeodezisë, e dini sa vërejtje i kame marre për shkak se kam deshtë që krejt këto prona mi qitë në pronë të Komunës. Jam kërcënuar edhe shumë herë edhe prej atëherë ka qenë AKM-ja edhe krejt ato nuk kanë shkuar. Duhet ta pranojmë se faktori politik ne Kosove nuk po thamë ne Viti, d.m.th ndoshta e ka zanë edhe te pa përgatitur vetëm formimi i AKM-se ne atë kohë dhe e ka gjvëshë jo vetëm Komunën e Vitisë, por i ka gjvëshë shume komuna ne mesin e tyre edhe Vitinë. Nga titullarët ja ka bartë organizatave, unë e di që edhe qeveritë e kalueme, nuk dua ta fajësoje se i kanë bë ato përpjekjet e veta për kthimin e tyre nuk kanë mujt me arrit nuk kanë mujte, duhet ta pranojmë dhe prej ardhjes ne qeveri Kryetari i Komunës, Sokol Haliti, përpiluesi i atyre shkresave kam qenë unë, që i ka nënshkrua kryetari vazhdimisht, ka bë përpjekje, janë nja 7 a 8 a 10 mos ti numëroj me numër, i kem qu Zyrës Regjionale ne Gjilan, a Qeverisë së Kosovës a ishe presidentes së Republikës se Kosovës, kryetarëve te Kuvendit dhe i kemi marr dhe ka arritur çështja te ngritët. Me iniciativën e kryetarit te Komunës është thirre Kuvendi i Asociacionit të Komunave te Kosovës ne javën e kaluar, munde te pyetni e kam shkresën edhe aty dhe kjo çështje u ngri dhe është ardhë një shkresë, te cilët kanë thanë do te rishqyrtohen çështja e pronave, sidomos te tyre te cilat janë pa privatizua që i ka zane pa privatizuar dhe ta shohim do te ngritët edhe një komision ndërministror dhe çka është e mundshme dhe te kalohet si prone e komunës. A kem kohe ne mi prit ato shtrohet çështja, unë konsideroj se për momentin jo jemi dy komuna kandidate për përfitimi e projektit, është fjala për Komune e Vitisë dhe te Rahovecit. Unë kame biseduar shume herë me këshilltarin Agim Gashi të ministrit te Punëve te Brendshme, te cilët u kanë dhëne kushtet urbanistike atij, është kërkuar nga ana ime që te vjen ta bënë kërkesën për leje te ndërtimit, pavarësisht se a është institucion, ai duhet te pajiset me leje te ndërtimit. Është kërkuar që ta këtë një vendim nga ana e kuvendarëve, se ku duhet te vendoset dhe te fillon krejt dokumentacioni te plotësohet dhe te fillojmë. Jem para dy dilemave, vetëm një te cilin a domë ta ndërtojmë objekti e zjarrfikësve a domë ta aprovojmë këtë propozim vendim me krejtë ato te metat nuk du te lëshohem, por e di që këto te meta i kanë bë nga pa dëshira nga pa mundësia me bë diçka me shume, dhe tani ta shqyrtojmë mundësinë që a ka mundësi, unë konsideroj që jem ne hape që ne duhet ta fitojmë objektin e zjarrfikësve, ne do te jem ata te cilët masandej e bëjmë hulumtimin krejt çka është mundshme dhe ne rast se

vendos kuvendi a e bëjmë ndërrimin nuk është shume problem, por problemi është qe na me e fitu projektin. Jemi ne këtë fazë, unë konsideroj qe te gjithë këshilltaret e Kuvendit Komunal janë për me e fitu projektin, prandaj pa dallime kisha kërkuar prej juve qe e lype momenti qe ne ta aprovojmë ne këtë formë. Kush do prej jush se bashku me ne mujmë edhe nga një përfaqësues nga partitë politike prej këshilltarëve, është fjala se gjithë herë aludoj ne institucion, se institucionet për mu janë te shenjta, pavarësisht se kush janë ato se kanë dal nga vota e popullit dhe ta hulumtojmë, edhe pse e kem kogjo problem, por ta hulumtojmë mundësinë ne rast qe kem mundësinë masandej mase një kohe ne si ta fitojmë projektin, Kuvendi i Vitisë vendos ta bene ndërrimin e lokacionit dhe vendosmi me një vend tjetër, nuk është problem se ai objekt është i gjithë i juve e i gjithë qytetarëve te Komunës së Vitisë, prandaj unë konsideroj se kjo është gjendja. Unë kem bere përpjeke, se bashku me ekzekutivin, se e marr shume afër, se te gjitha ato qe thuhet ne komitet, që me te vërtet te jem te përgjegjshëm, kjo Bekim, ti e din qe materiali është ardh, se sikur qe materiali i Kuvendit mos te ishte shpërnda, ne i kishim bërë edhe këto përmirësime. Ju ka njoftuar kryesuesi, se edhe unë kam qenë ne mbledhje te KPF, prandaj kisha kërkuar nga ju qe te kemi mirëkuptime dhe me te vërtet te garojmë me komunën e Rahovecit, se na jem me afër qe te fitojmë këtë projekt, por për ndryshe ne rast qe nuk i kryem këto, projekti shkon ne Rahovec dhe e gëzofshin ata. Kështu është gjendja, qeshu me ka than, prandaj kërkoj nga ju qe te kemi mirëkuptim dhe ta aprovoni këtë propozim vendim dhe masaneje te shikojmë krejtë mundësitë se ku do ta vendosmi atë objekt te zjarrfikëseve. Për momentin na kërkohet qe na ti plotësojmë kushtet tona si komunë, edhe “Hidromorava” e kame than edhe ne komitet, e cila është me objekt aty, është shkresa e tretë a katër qe vjen, ju kane kercnu “Hidromoraves” me e jeke prej aty ose për ndryshe me pagu qira. Ti kem te kjarthe këto sene, se para çfarë sfidave jem. Tash unë nuk po du me than kush me fajtoje, kush me pak e kush me shume, por gjendja është kjo, na kemi gjetë këtë gjendje e ne jemi ata te cilët duhet me dal nga kjo gjendje dhe për me dal nga kjo gjendje duhet te shiqojmë se cila është me e mira e mundshme për momentin dhe konsideroj qe kjo të cilën e keni para jush, prandaj edhe një herë ju kisha lutë qe te keni mirëkuptime dhe me te vërtet te hecim hapave se bashku, kur është fjala për te mirën e qytetarëve te Komunës se Vitisë. Ju faleminderit!

Kryesuesi z.Naim Pira: Faleminderit Nënkryetar, me te vërtet është hera pare qe unë jav sjelli materialet pa u mbajte seanca e Komitetit për Politik dhe Financa, qëllimi i ngutjes ka qenë për faktin se nga Ministria na ka kërkuar qe rishikimi i buxhetit te ndodhe deri me datën 25, me çdo kushte, përndryshe nuk do te mund te ketë rishikim te buxhetit, dhe natyrisht qe unë për me shfrytëzua atë hapësirën ligjore qe jemi te obligueshëm, 7 ditë para se te mbahet seanca te ju sjellim materialin, unë jam ngut dhe e kam sjell materialin pa kalue ne KPF, dhe natyrisht e shpjegoj shume mirë nënkryetari, se dallimi i këtyre ndarjeve te parcelave me numra ekziston pikërisht ne qeta dhe meçe se ne këtu e kemi përfaqësuesin e Zyrës Ligjore, unë po shpresoj që ata qe e propozoj edhe nënkryetari qe do ti korigjojme numrat me propozim vendime dhe nëse kemi te drejt edhe nëse është e drejt ligjore, pse mos ta bëjmë ndryshimin e këtyre, dhe natyrisht ta votojmë, ngase është ne te mirë të qytetarëve te Komunës se Vitisë, qe projekti i cili është si donacion ta fitojmë.

z.Samet Idrizi: Grupi i këshilltarëve te PDK-se është gjithsesi pro ndarjes se parcelës për objekti e zjarrefikesve, unë e dëgjova Dautin kur tha, ne mundem me mbajt edhe një seance te jashtëzakonshme për ketë punë edhe jemi te gatshim me majte masë një jave ose mase tri ditëve. Çështja është qe ne propozojmë me kohe tash me hulumtuar një lokacion, dhe nëse pajtohemi edhe ju tjetër brenda javës me thirr edhe një seance te jashtëzakonshme edhe e votojmë e kalojmë ketë çështje. Ju faleminderit!

z.Daut Xhemajli: Unë edhe një herë e kame parasysh propozim vendimin, e kam parasysh qe ka edhe një kërkesë për hulumtim te lokacionit tjetër. Na ne komitet e kemi vendos, me një formë jemi orientuar për këtë lokacion, me mundësinë siç e përmendi edhe nënkryetari, qe si

variant te shkon ky, ndërsa nëse eventuali gjejmë zgjidhje me te mirë si Komunë, atëherë te vije propozim vendimi për ndryshimin e vendit edhe kurrëgjë kërkujt, nuk humbë komuna nëse i qonë ato letra edhe i shtinë ne atë propozim, që qohet vendimi për ndarjen e vendin, vendimit te ri. Pra, unë e kam një propozim për zgjidhjen e këtij problemi, kështu qyshe ka ardh, çeky qe me javë lëne mundësinë drejtorisë dhe eksperteve te komunës, qe vendin, se një herë na e mbajmë ndarjen edhe një herë mujom me biseduar për qatë vend, na përditë nuk marrim vendime qyshe me nda atë vend. Propozimi ime është që neni 2 me kushte, d.m.th qe me shtrirjen e qeti vendi qashtu qe është e pa kuptim me ndryshuar edhe me bë pak me ndryshe. Problemi është qetu me lëne hapur mundësinë me nenin 2, lokacioni i propozuar për ndërtimi e objektit te zjarrefikesve është ne parcelat 2496-1 dhe nuk po shoh numra nëse çekja parcel qetu ku është një objekt, nëse çekja parcele ka numra tjerë dhe numrin, ky numër, d.m.th i qesaj parcele këtu, të jemi te qarte me sipërfaqe u tha 2800, por na afërsisht 3000m², i bien 30 ari, edhe ky 5900 bien, d.m.th ne zonën katastrale ne viti, e cila është në pronësi te Komunës se Vitisë. Unë po besoj shume dhe nuk kam as një dileme qe ky vend ky çekja sipërfaqe qe nuk e ka numërinë tash është pronësi e komunës, se mos mu pas kanë pronësi e komunës na objektin e sociales nuk kishim mujtë me ndërtuar, por qëllimi, ideja është se nëse jemi dakord, qe këtu duhet te vendoset tash për tash, atëherë bile vendin te ja caktojmë me këtë propozim vendimim, me këtë shënim ndryshe, me këtë shënim na nuk mujmë me miratua. Faleminderit!

z.Ekrem Abazi: Përshëndetje për te gjithë te pranishmit! Mendoj si qytetar i kësaj komune, qe vendi nuk është bashe i përshtatshëm, por pas sqarimit qe bëri zv.kryetari, mendoj qe donacioni nuk duhet kurrsesi te humbet, dhe ne ta votojmë sot këtë propozim vendim dhe njerëzit përgjegjës për këtë pune te këshyryn najë lokacion tjetër, nëse ka mundësi, nëse nuk ka, duhet patjetër ta pranojmë këtë vend ku e kemi, megjithatë është i pa përshtatshëm, por po e përsëris, donacioni nuk duhet kurrsesi te humbet.

Kryesuesi z.Naim Pira: Meqenëse edhe përfaqësuesja i Zyrës Ligjore najë konfirmoj se mund të bëhen ndryshime, ne propozim vendimin, natyrisht me propozimet te cilët i dha Dauti, që të bëhet ndarja e parcelave ashtu qe te shënohet me numra, unë po e hudhi në votim këtë propozim vendime, lusë qe me vonë te korrigohet dhe te rregullohet propozim vendimi: Kush është qe te kaloj ky propozim vendime ju lutem me ngritje dore? Konstatoj qe 25 këshilltar komunal janë prezent, ju lutem sekretaria numëroj. Do te thotë me 20 vota pro dhe 5 abstenime kalon ky propozim vendim.

Pika e tretë

Propozim vendim për hartimin e planit të veprimit lokal në mjedis

Kryesuesi z.Naim Pira: Si pikë e tretë e rendit te ditës e kemi propozim vendim për hartimin e planit të veprimit lokal në mjedis, ftoj drejtorin e Urbanizmi qe ta merr fjalën.

Drejtori z.Ajet Sallahu: Përshëndetje Kryesues, Nënkryetar, Këshilltar të nderuar, koleg Drejtor, Kryetari i Komunës! Propozim vendimi për hartimin e Planit te Veprimit Lokal ne Mjedis, në të cilën mirën iniciativa për hartimin e planit veprimit lokal ne mjedis te Komunës se Vitisë, Kryetari i Komunës formon grupin punues për hartimin e këtij plani, ne te cilin përveç zyrtareve komunal, ne këtë grupe janë te përfshirë edhe përfaqësues nga ndërmarrjet qe kryen shërbime publike, përfaqësuesit e OJQ-ve, dhe përfaqësues te komitetit te biznesit. Kuvendi i Komunës, me rastin e aprovimit te buxhetit te Komunës, do te planifikoj edhe mjete buxhetore ne fondin dhe bashkëfinancim me donatore, për implementimin e këtij plani. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit, Mbrojtjes dhe Mjedisit, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Gatishmëria Emergjence, Drejtoria për Inspeksion dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa. Ju faleminderit, nëse ka pyetje për sqarim urdhëroni.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat rrethe diskutimit te kësaj pike te rendit te ditës.

znj.Mirlinda Sadiku: Me vjen mirë qe filluat te mendoni për mjedisin, për ruajtjen e tij, sepse duhet me te vërtet te brengosemi se çka po ju lemë nipave e mbesave tanë, megjithatë kame pyetje për drejtorin. Ky plan i veprimit parashihet për vitin 2017, d.m.th, kur te fillojnë

me përgatitjen e buxhetit, për shkak se ka me pas edhe duhet të këtë kosto financiare, edhe ndoshta do të ishte mirë që të përfshihet edhe Drejtoria e Bujqësisë, është mendim i imi, sepse e kemi Drejtoria e Bujqësisë, d.m.th në bashkëpunim me Agjencionin e Pyjeve, ka të drejtën ekskluzive për ripyllëzimin e pyjeve, të cilët janë shkatërruar, ku jemi dëshmitar që në vitet e fundit kemi pas prehe të shumta nëpër pyjet e Vitisë, po ashtu ka pas edhe zjarre. Jemi dëshmitar që kemi edhe deponi ilegale, nëse nuk gaboje, që kryetari ka pas thanë, që rreth 43 janë identifikua, edhe dita ditës ka edhe materiale inerte, ka materiale të ngurta nga shtëpitë që prishen, prandaj kjo do të ishte mirë që të artikulohej. Në kuadër të këtij plani edhe Drejtoria e Bujqësisë, sepse dita ditës kemi edhe shume degradime të mjedisit, ku tokat bujqësore po bëhen, d.m.th kthyerjen e hapësirave ndërtesë. Ju faleminderit!

Kryesuesi z.Naim Pira: A ka dikush tjetër që ta marr fjalën? Pasi që nuk ka po e hedhim në votim për miratim: Kush është që të miratohet edhe kjo pikë e rendit ditës, kush është pro?, ju lutem me ngritje dore. Konstatoj që me votat e të gjithë të pranishmeve u miratua edhe pika e tretë e rendit të ditës.

Pika e katërt

Raport mbi vlerësimin e kushteve për dhënien e pëlqimit për leje të nderimit.

Kryesuesi z.Naim Pira: Për pikë të katër të rendit të ditës kemi: Raport mbi vlerësimin e kushteve për dhënien e pëlqimit për leje të nderimit. Gjithashtu ftoj drejtorin e Urbanizmit që ta marr fjalën rrethë këtij propozim vendimi, urdhëro Drejtor.

Drejtori z.Ajet Sallahu: Faleminderit Kryesues! Në mungesë të kryesuesit të komisionit, pasi propozimi është bërë nga Drejtoria e Urbanizmit, atëherë po e paraqes edhe këtë raport mbi vlerësimin e kushteve për dhënien e pëlqimit për leje të nderimit, pranuarit Përparim Hasani, ka bërë kërkesë për ndërtimin e objektit në zonën ku është e parapamë me plan rregullues urbane dhe në baze të planit rregulluar urbane parashihet që të ndërtohet objekti P+4, dhe që për objektin P+4 është e parapamë që të jen 12 (dymbëdhjetë) ari, apo 12 mijë m², prandaj drejtoria e ka refuzua, mirëpo në plani rregullues urban parashihet që nëse me formimin e një komisioni nga ana e Kryetarit të Komunës, të përbërë nga një inxhinier i ndërtimtarisë, një i arkitekturës një ambientalist, dhe një ekonomist dhe një jurist i diplomuar, mundet të shqyrtohet për kushtet e ndërtimit edhe në një sipërfaqe me të vogël edhe deri në 7 (shtatë) ari. Pronari në fjalë i ka aty parcelën prej 8 ari, dhe aty komisioni ka konstatua se në hapësirën prej 8 ari mundet të ndërtohet objekti P+4. Prandaj edhe e qesim për miratim në Kuvend. Ju faleminderit!

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapim debatin rrethë kësaj pike: A do dikush fjalën ju lutem?

z.Samet Idrizi: Siç tha edhe drejtori i Urbanizmit, në rastet kur edhe Drejtoria e Urbanizmit, ose është ofruar një projekt i cili nuk është konform ligjeve mbi ndërtim, aty kjo çështje kalon të komisioni. Na e pame që një komision e ka formuar kryetari dhe komisioni u merr me këtë punë, shpresoj që punen komisioni e ka bere konform kompetencave të veta që i delegohej. Kërkesa është që pasi kjo punë të kalojë sigurish që do ta votojmë, të përcjellët puna në mënyrë strikte, se a po ndërtohet objekti konform rregullave të cilat lejohen aty, se kemi pas raste kur ka kaluar përmes komisioni, përmes Kuvendit, mandje atje kuotat kanë ndryshuar. Ju faleminderit!

Kryesuesi z.Naim Pira: Dikush tjetër a done fjalën?, pasi që nuk ka, atëherë unë po e hedhi në votime për miratim: Kush është që të miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës?, ju lutem me ngritje dore. Kundërt nuk ka, abstenim nuk ka, nga të gjithë prezent konstatoj që u miratua edhe pika e katërt e rendit të ditës.

Pika e pestë

Propozim vendim për rishikimin e buxhetit komunal për vitin 2016.

Kryesuesi z.Naim Pira: Ftoj drejtorin e Financave, z.Ibrahim Ramën, që ta merre fjalën rrethë këtij propozim vendimi.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Faleminderit Kryesues, përshëndetje për Nënkryetarin, te nderuar Këshilltar komunal, mjete te informimit, OSBE, dhe drejtorit përkatëse që janë prezentë në këtë Kuvend. Para jush e keni materialin, është fjala për propozim vendimin për rishikimin e buxhetit komunal për vitin 2016, një buxhet i cili është miratua nga ju në vitin e kaluar, në Shtator të vitit të kaluar, dhe që me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Komunitet kanë të drejtë të përdorin, përmes kryetarit të Komunës të parashohin edhe propozim ndryshim për buxhetin në fjalë, dhe kësaj radhe edhe në e kemi pa të arsyshme që buxheti i vitin 2016 ka arsye të rishikohet, atë e lejon edhe ligji dhe kështu është pak një procedurë e përshpejtuar kësaj radhe, se konfirmimi se duhet të fillohet me rishikim të buxhetit e kemi marrë me datën 17.05.2016, kështu që deri me datën 24.05.2016 në duhet ta qojmë vendimin mbi rishikimin e buxhetit, d.m.th e kemi një afat shumë të shkurte për këtë arsye edhe kryesuesi i Kuvendit e shpjegojë që është dashur edhe në mbledhje të Kuvendit të përshpejtohet dhe gjatë kësaj periudhe.

Në kemi vendos që para juve ta paraqesim një propozim vendim për rishikim të buxhetit që KPF-ja e ka kaluar, d.m.th për Kuvend dhe ky rishikim i buxhetit e ka parasysh buxhetin e vitit 2016, të aprovuar nga ju, është fjala gjithmonë të kuadër të kodit për investime kapitale, është fjala për 100 mijë euro, kemi menduar që na me buxhet të viti 2016 e kemi paraparë ndërtimin e shkollës fillore në fshatin Pozharan dhe kemi nda mjete në vlerë prej 100 mijë euro, që është miratua në Kuvendin komunal. Kështu që këto mjete ndërkohe me buxhetin e Ministrisë së Financave është planifikua ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Pozharan, dhe ajo vlerë është 1 milion e gjysmë, edhe ashtu shkolla fillore kushton, është një shumë shumë e madhe për financim, që buxheti i Komunës së Vitisë është i pa mjaftueshëm në plotëni me plotësua këtë buxhet për ndërtimin e kësaj shkolle, por qëllimi, jo edhe i juve, sigurisht ka qenë kur e kemi votu buxhetin, që kjo ndarje prej 100 mijë euro të ndikon në mënyrë politike apo me mirë me thane edhe moralisht në institucionet e nivelit qendror, që ta kenë parasysh ndërtimin e një shkolle, që e dimë të gjithë që është në kushte shumë të renda, aty ku mësojnë fëmija dhe për këtë arsye në e kemi nda një fond prej 100 mijë euro. Dhe pasi Ministria e Arsimit i ka nda mjetet buxhetore për ndërtimin e kësaj shkolle, në e kemi pa të arsyeshme që këto mjete të ridistinojmë në pjesën tjetër të kodit për investime kapitale, që është fjala për projektin “participimi i projekteve me donatore” dhe kjo koïncidon që në mbledhje të kalime edhe ju e votuat propozim vendimi për marrje të obligimit, pagesën e obligimit Qeverisë zvicerane, që përmes implementuesit CDI-se është trashëguar një borxhe për implementim apo me mirë me than përfundimi e projektit të ujësjellësve të 5 fshatrave të Komunës së Vitisë, dhe që jemi pajtuar edhe ju edhe në si qeveri komunal, që këtë borxhe ta paguajmë dhe kjo ndërkohe i plotëson, d.m.th në zhargonin popullor, që thonë me një të ramë dy të vramë. Këto mjete që i kemi nda për shkollën e fshatit Pozharan, të rishikojmë në projektet tjetër participim me donator, që në të njëjtën kohë do të shtyjmë edhe obligimin që e kemi ndaje implementimit të projektit të ujësjellësit, është fjala për CDI-në, pra, krejt është kjo logjika e këtij propozim vendimi. Unë kërkoj nga ju që të miratoni, është në të mirë e të gjithë qytetarëve edhe ligjërish kemi të drejtë me bë rishikimin e buxhetit, për ndryshe nëse vazhdohet kështu me ndodhe, se ka pas zëra se me ridestininim të atyre mjeteve të ndajmë ata që merren me ekonomi, e din që ridestininimi nuk guxon, e ligji nuk e parasheh që të shuhet një projekt dhe të plotësohet një projekt tjetër, kështu që rishikimi i buxhetit e ka këtë të drejtë dhe naj mundëson edhe ligjërish edhe anën formale edhe ligjore që këto mjete të ridistinojmë në fondin participim me donator, pra kjo edhe një herë është liga e këtij propozim të rishikimit të buxhetit. Kërkoj nga ju që të miratoni dhe të keni mirëkuptim. Ju faleminderit!

Kryesuesi z. Naim Pira: Hapim debat.

znj.Vjollca Kadolli-Halili: Pas arsyeshmërisë dhe sqarimeve të cilat i dha drejtori i Financave për këtë propozim vendim, grupi i këshilltarëve të LDK-se është në përkrahje të këtij propozimi.

znj.Selvie Rexhepi: Edhe unë kam pritë rishikimin e buxhetit, duke e marr parasysh se kemi miratua rregullore, strategji, qe kanë pas kosto financiare. Rishikimin e kam pritë se kam menduar se rregulloret janë miratuar edhe sigurish edhe masë ose fillimit te vitit 2016. Kështu duke e menduar se ato kane kosto financiare, kam menduar qe me rishikim sigurosh se do te ketë ndarje buxhetore. kisha pyet drejtorin edhe për këtë projekt qe është bërë, d.m.th ridistinimi i mjeteve është krejt e arsyeshme, mirëpo ku do te mbetemi pastaj me ato rregullore qe i kemi miratua, megjithatë ato strategji qe i kemi miratua çka është ne pyetje qe nuk ja kemi dhen mundësin qoftë pak mjete financiare te ndahet edhe për ato qe me qellim qe te filloj puna edhe deri sa ky Kuvend ka miratuar ato rregullore. Ju faleminderit!

z.Bekim Azizi: Te rishikimi i buxhetit, qe është ne rregulle te behet rishikim ne këtë gjashte mujore, unë e shohë qe prej kodit buxhetor për investime kapitale këto 100 mije euro qe janë paraparë për shkollën e Pozharanit duhet te barten, sepse vetëm është bere investimi tash prej Qeverisë, e ka marre obligim, mirëpo është e dyshimtë, sepse kemi pas deri tash shume projekte, unë e di qe te gjitha projektet deri tash nuk kane kaluar shume qe e kanë paraparë çdo projekt, munde me pas mjete te gjitha ato mbetje u deshtë qe te parashihen ne këtë ridistinim ose rishikim te buxhetit, d.m.th asnjë nuk ka hi tjetër, d.m.th prej 1 milion e 300 mije euro çka i kemi pas investime kapitale nuk ka as nje kod buxhetor tjetër në investime qe rishikohet, d.m.th gjithçka e keni planifikua te sakte, qe nuk tepron as një cent, d.m.th nëse një euro tepron prej një projekti u dashtë te hynë ne rishikim dhe te bartet diku tjetër. E kemi paraparë na edhe te Plani i Mobilitetit nja 50 mije euro sivjet, qe kanë pas me hi ne rishikim për mi krye do pune, ajo nuk është askund. Te plani kur e kemi miratuar, te personat me nevoja te veçanta, edhe aty kemi paraparë diçka kame shti diçka me krye për këtë vit, ne nuk kemi shti asgjë, na krejt i kemi menduar se me rishikim kemi mi analizua me u be diçka asnjë nuk ka hy, d.m.th edhe kjo len hapësirë për me dyshuar se ato mjete, se mbesin barten në projekte tjera me vendime te veçanta, sikur i keni bartur ma herët me shkelje te ndryshme, sepse ajo formë po ju konvenon, nuk është e arsyeshme për deri sa nuk kanë hy kodet tjera buxhetore ne rishikim dhe mendoj se nuk është bere mirë rishikimi këtu.

Drejtoi z.Ibrahim Rama. Po ju falenderoj për pyetje. Kur është përgatit buxheti për vitin 2016? Procesi ka filluar dikun ne muajin Maj e ka përfund deri ne shtatorë, krejt çka ka pas mundësi mu inkurpuruar ne buxhet kemi qen transparent besoj mjaftueshëm edhe pse ai buxhet krejt e kemi thanë qe nuk ka qen i mjaftueshëm ne vlerën nominale mi plotësuar te gjitha nevojat e qytetarëve të Komunës se Vitisë, apo me mirë me than prioritetet e Komunës se Vitisë po megjithatë ato qe i kemi pas mundësi me këtë buxhete me këtë vlere te buxhetit ne e kemi paraparë ne buxhet dhe buxheti nuk munde te ndryshohet, përveç kur te ka mundësi financiare apo shtese buxhetore apo naj gabim qe është gjate procesit te përgatitjes se buxhetit.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi nuk ka për të diskutuar e hedhim ne votim që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës. Me 18 vota pro, 3 kundër dhe 1 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Unë ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë, mirë u pafshim në seancat e radhës.

Mirë u pafshim!

Mbledhja përfundoi me punë në ora 11 e 45 min.

Procesmbajtës :
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal-Viti
z.Naim Pira